

MOTIVIMI I EMËRTIMIT TË FËMIJËVE NË KOSOVË 1912-2008 THE NAMING OF CHILDREN IN KOSOVA 1912-2008

NEBI CAKA¹, ALI CAKA²

¹ Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike

² Fakulteti i Filologjisë

Universiteti i Prishtinës, Prishtinë, Kosovë

Email: nebi.caka@fiek.uni-pr.edu, ali.caka@gmail.com

Përmbledhje

Sa njerëz me emrin *Vlora, Saranda, Valbona, Labinot, Tomor a Berat* ka sot në Kosovë? Po me emrin *Migjen, Nola Asdren?* A e di *Saranda* që emri i saj do të thotë 'dyzet' në greqisht, e *Berati* se emri i tij rrjedh nga Beligrad (qytet i bardhë, në sllavisht). A e di kosovari me emrin *Azdren* se emri i tij paraqet shkronjat e para të emrit e mbiemrit të shkrintarit Aleks Stavre Drenova, ndaj do të duhej të shkruhej *Asdren*. A e di *Naseri* pse e kanë quajtur me këtë emër? Po *Medlin, Tonibler* e *Klinton?* Ç'kanë të përbashkët *Fitorja* e lindur më 1945 dhe *Fitorja* e lindur më 1968? Sa vjeç është *Pavarësia?* Si e shpjegon *Fideli* emrin e vet, po *Enlirat?* Në këto dhe në shumë pyetje të tjera që kanë të bëjnë me emërtimin e fëmijëve në Kosovë në periudha të ndryshme në harkun kohor 1912-2008 do të përiqemi të japim përgjigje në këtë punim. Do të jepet po ashtu klasifikimi i emrave, si dhe lista e 100 emrave më të përdorur mashkullorë dhe lista e 100 emrave më të përdorur femërorë, të përpiluara në bazë të një korpusi prej 1.500.000 emrash, të marrë nga regjistra e lista të ndryshme, si 'listat e pensionistëve', 'listat e përfutësve të shtesave të fëmijëve', 'listat e studentëve të regjistruar në Universitetin e Prishtinës', 'listat e votuesve', ditarët e shkollave fillore e të mesme etj.

Fjalët çelës: Emrat shqip, klasifikim i emrave, emërtimi i fëmijëve, 100 emrat më të përdorur mashkullorë, 100 emrat më të përdorur femërorë

Key-words: Albanian names, name classification, naming of children, top 100 female names, top 100 male names

Hyrje

Sikurse te popujt e tjerë, ashtu edhe te shqiptarët shtresa më e vjetër e emrave të njerëzve, janë emrat vejjakë. Emrat vejjakë të shqiptarëve të Kosovës mund të klasifikohen si më poshtë:

- Emra popullore shqiptarë, si: *Bardh, Bardhosh, Ujkan, Ukë, Sose, Shkurte, Zojë* etj.
- Emra me burim nga ndonjë fjalë e gjuhës shqipe a 'emra apelativë', si: *Agim, Bekim, Besa, Bleta, Bilbil, Blerim, Blini/Bliri, Burim, Dallëndyshe, Dashurie, Det, Dielli, Diellëza, Drandafille, Dredhëza, Drita, Drenusha, Fitore, Fjollë, Flaka, Hana, Karafil, Lirie, Luan, Lule, Lulebora, Lulevere, Lum, Mal, Manushaqe, Menekshe, Merita, Mimoza, Mjellma, Murrilan, Natyra, Petrit, Pëllumb, Pëllumbesha, Rush, Shegë, Shotë* (mbase edhe sipas Shote Galicës), *Pranvera, Qiell, Shpend, Shqipe, Shqiponja, Trëndelina, Vesa, Vjollca, Zana, Zog, Zoqe* etj.
- Emra të formuar nga fjalë të shqipes, si: *Alendita, Besarta, Besbardha, Besëforta, Besëjona, Besëlidhja, Besëmira, Fatgëzim, Fatlindje, Fatvera, Lindita, Linditrim, Liridon, Liridona, Liridokena, Lirigëzona, Lirijona, Lirikena, Megzim, Shqipdona, Shqipridona, Vjendita* etj.
- Emra nga gjeografia e Shqipërisë dhe e Kosovës, si: *Adriatik, Albulena, Arta, Berat, Butrint, Delvina, Drin, Drilon, Durrës, Elbasan, Erenik, Fierza, Labinot, Lumbardh, Jon, Kaçanik, Korab, Preveza, Prishtina, Saranda, Shkodra, Sazan, Shar/Shar, Shkëlzen, Shkumbin, Shqipërie/Shqipnije, Tirana, Tomor, Valbona, Vjosa, Vlora/Vlona* etj., po dhe *Çamëri, Dukagjin, Kosovë, Martanesh*.
- Emra banorësh visesh shqiptare (ilire), si: *Arben, Arbër, Arbnesha/Arbresha, Arbnor, Arbnore, Dalmat, Dardan, Dardane, Dibran, Epirot, Llapjan, Kosovar, Kosovare, Matjan, Matjane, Opojare, Peonare,*

Shqiptar, Shqiptare, Shkodran, Shkodrane, Tropojane, Vlonjat.

- Emra nga letërsia dhe historia shqiptare, si: *Asdren, Atfshita, Bajramcurr, Fannol, Lasgush, Marigona* (sipas atdhetares Marigo Posio, e cila e ka qëndisur flamurin të cilin Ismail Qemali e ngriti në Vlorë, më 28 nëntor të vitit 1912), *Migjen, Nita, Tringa* etj.
- Emra nga historia arbërore e ilire, si: *Agron, Bardhyl, Genc, Gent, Skenderi/Skënder, Skenderbe, Skenderbeg, Kastriot, Lekë* (sipas Lambertz-it, emri *Lekë* nuk del nga *Aleksandër*, por nga emri ilir *Licaus, Licca*), *Pirro, Pleurat, Teuta*.
- Emra ilirë ose që lidhen me ilirët, si: *Ardian, Ardiana, Etleva, Etrit, Taulant, Taulanta* etj.
- Emra nga tradita islame (kryesisht me origjinë arabe, po dhe perse): *Abdullah, Ajshe, Ali, Fatime, Emine, Muhamet, Emin, Hasan, Hysen, Ymer* etj. Këtu bëjnë pjesë edhe emrat nga tradita islame, por që me shqiptim të përafërt i hasim edhe te të krishterët (e që janë kryesisht me origjinë hebraike), si ato të profetëve: *Adem, Daud, Harun, Isa, Jahja, Jusuf, Musa, Sulejman, Zeqirja* etj.
- Emra nga turqishtja, si: *Asllan, Kapllan, Murat, Orhan, Shemsije, Turkan* etj.
- Emra popullore nga tradita e krishterë/katolike (kryesisht me origjinë hebraike ose greke): *Dedë, Engjëll, Gjergj, Gjon, Kolë, Luigj, Llukë, Marie, Marte, Mikel, Mhill, Ndue, Pjetër, Pashk, Pashke, Pjeter/Pjetër, Shtjefenl/Shtjefën, Zef* etj.
- Emra nga mitologjia greke dhe romake, si: *Adonis, Antigona, Hera, Venera* etj.
- Emra shekullarë të huazuar nga kulturat e tjera, si: *Adelina, Aida, Albert, Diana, Edison, Edmond, Elmedina, Ernest, Hektor, Liliana, Robert, Valentina* etj.
- Emra të 'modës', si: *Elvis, Ines, Roland* etj.
- Emrat kompozita e shkurtesa, si: *Debatik* (nga: Djemtë e Bashkuar Anëtarë të Idesë Komuniste, organizatë antifashiste e fëmijëve, që vepronte në Shqipëri gjatë Luftës së Dytë Botërore nën drejtimin e Rinisë Komuniste të Shqipërisë); *Geteoar* (nga: Gegë – Toskë – Arbër), *Marenglen* (nga: *Marks-Engels-Lenin*), por dhe: *Enlirat* (nga: *Enver lirroje atdheun*, sipas E. I., lindur më 1989) dhe *Fidel* (nga: Fillimi i demokracisë e lirisë, sipas F.K., lindur më 1981).
- Emra nga historia më e re, si: *Tonibler* – sipas liderit britanik Toni Bler, *Klinton* dhe *Bilkinton* – sipas presidentit amerikan Bil Klinton dhe *Medlin* – sipas sekretares së shtetit të SHBA, Medlin Olbrajt, të cilët e kanë mbështetur ndërhyrjen e NATO-s në Kosovë në vitin 1999; *Klark* – për nder të gjeneralit amerikan

Wesley Clark, i cili udhëhoqi bombardimet e NATO-s, nga 24 marsi i vitit 1999, për 78 ditë me radhë kundër Serbisë (Gashi 2010).

- Me historinë më të re lidhet edhe emri: *Pavarësi* – Vajza e parë që ia vunë këtë emër ka lindur në Prishtinë, dy minuta pas leximit të Deklaratës së Pavarësisë (së Kosovës) më 17 shkurt 2008.

Historiku i emërimit masiv të fëmijëve me emra shqip e ilirë

Në Shqipëri, në kohën e komunizmit, duke filluar nga viti 1975 për të regjistruar foshnjën në zyrën e gjendjes civile, prindërve u jepnin një fjalor/katalog me 6000 emra shqiptarë e ilirë dhe ata duhej të zgjidhnin midis tyre (Koti 2010). Diskutimi për këtë çështje kishte filluar qysh më 1963 në gazetën Mësuesi (Kostallari 1963).

Sic vëren Yllka Selimi: "Pas viteve 1970 u dukën edhe të metat në këtë përpjekje. Zëvendësimi i emrave fetarë dhe numri i kufizuar i burimit ilir/shqiptar hapi terren të favorshëm për hyrjen e shumë emrave të huaj laikë." (Selimi 1989).

Në Kosovë, as në këtë kohë, e as më vonë, prindërve nuk u jepej një listë e tillë dhe as nuk u imponohej zgjidhja e emrit, ndaj zgjedhja e emrave shqip për të emërtuar fëmijët e tyre tregon dëshirën dhe vendosmërinë e tyre që të tregonin se shqiptarët e Kosovës dhe ata të Shqipërisë janë një komb i vetëm.

Kështu, p.sh. *Ademi* (1942) dhe *Alija* (1950) i emërtuan që të gjashtë fëmijët e tyre me emra shqip: *Amshim* (1972), *Arsim, Agron, Arlinda, Arben, Agon* (1987). Kështu vepronin edhe prindërit e tjerë.

Emërtimi i fëmijëve me emra shqip në këto hapësira patë filluar shumë më herët. Mësuesi dhe atdhetarit i njohur Ibrahim Fehmiu (Gjakovë, 1892 – Prizren 1951), të tetë fëmijëve të vet, të lindur në harkun kohor 1925-1939, u pat vënë emra kuptimplotë shqip: *Besa, Shpresa, Bashkim, Luljeta, Arsim, Fatmir, Bekim, Afërdita*, e sipas emrit të njërit prej tyre, aktorit të njohur Bekim Fehmiu (1936), me mijëra prindër i emërtuan pastaj djemtë e tyre të porsalindur.

Me të përfunduar Lufta e Dytë Botërore (1945), por edhe gjatë luftës disa nga prindërit filluan t'u vënë fëmijëve të tyre emra thjesht shqip, si: *Afërdita* (mbase sipas romanit të Sterjo Spasses), *Afrim, Afrore, Agim* (duke menduar se dolën nga errësira), *Agron, Arsim, Bardh, Bashkim, Besa, Besim, Besnik, Blerim, Bujar, Bukurije, Burbuqe, Burim, Drita, Driton, Dukaçjin, Dhurata, Fatmir, Fatmire, Fatos, Fitim, Fitore* (ndaj fashizmit), *Flutra, Gazmend, Genc, Gëzim, Hana, Ilir, Jeta, Jeton, Kreshnik, Kujtesa, Kujtim, Lirije* (duke menduar se e fituan lirinë), *Luan, Lule, Luljeta, Lulzim, Lumni, Petrit, Pranvera, Shar, Shkelzen, Shpend,*

Shpëtim, Shpresa, Shqipe, Teuta, Valbona, Veton, Vjollca, Ylber.

Më vonë disa prindër filluan t'i emërojnë fëmijët e tyre me emra që së bashku jepnin një porosi ose krijonin një koncept, si: *Vjendita* dhe *Ejona* = Vjendita jonë; *Valon, Flamur* dhe *Vlorë* = Valon flamuri në Vlorë; *Drini* dhe *Bardha* = Drini i Bardhë etj.

Emërtimi i fëmijëve në Kosovë sipas periudhave në historinë e re

Për t'i hetuar më lehtë dhe më saktë prirjet e emërtimit të fëmijëve në Kosovë në harkun kohor 1912-1938, ky hark është ndarë në pesë periudha: 1912-1938; 1939-1948; 1949-1968; 1969-1988 dhe 1989-2007, të cilat karakterizohen me këto kthesa historike:

1912 – Pavarësia e Shqipërisë dhe pushtimi i Kosovës nga Serbia;

1939 – Fillimi i Luftës së Dytë Botërore;

1948 – Ndërprerja e marrëdhënieve shtetërore ndërmjet Shqipërisë dhe Jugosllavisë;

1968 – Demonstratat e studentëve dhe fillimi i lëvizjes për Kosovën Republikë

1989 – Fillimi i luftës përfundimtare për çlirimin e Kosovës nga Serbia

Nga krahasimi i 100 emrave të parë sipas periudhave historike, mund të konstatohet:

Në periudhat 1912-1938 dhe 1939-1948 që të 100 emrat e parë janë emra të traditës myslimane, me dy përjashtime, *Ukë* (emër popullor shqiptar) dhe *Zef* (emër popullor shqiptar i traditës së krishterë/katolike: *Jozeף*).

Në periudhën 1949-1968 na dalin vetëm 5 emra shqip: *Agim* (në vendin e parë), *Afrim, Besim, Lulzim, Agron*, si dhe emrat *Fadil* (mbase sipas Fadil Hoxhës), *Enver* (mbase sipas Enver Hoxhës) dhe *Skënder* (mbase sipas Skënderbeut), në vendin 5-7.

Në periudhën 1969-1988 kemi 54 emra 'myslimanë' dhe 46 emra shqip, dhe në periudhën 1969-2007 kemi 98 emra shqip ose 'modern' (si: *Leon, Leonard, Edison*) dhe vetëm dy emra tradicionale myslimane (*Muhamet* dhe *Bajram*).

Është interesant të ndiqet rangimi i emrit Bajram. Derisa ai zë vendin e parë në dy periudhat e para dhe të 3-tin në të tretën, bie në të 29-tin në periudhën e katërt, që të përfundojë në vendin e 98-të në periudhën e fundit.

Në periudhën 1949-1968 bie në sy emri *Naser* (mbase sipas presidentit të Egjiptit Abdel Gamal Naser), i cili del në pozitën e 11-të.

Te shqiptarët nuk ka emër *Tito* (siç është quajtur ish kryetari i Jugosllavisë). Edhe kur Tito ka qenë kumbar i fëmijës (fëmija i nëntë) atij nuk i është vënë emri Tito

(Koha ditore e Vitit të Ri 2010), por ndonjë emër tjetër, si Ramiz, bie fjala (sipas propozimit të vet Titos, për të kujtuar Ramiz Sadikun, i cili është pushkatuar së bashku me malaziasin Boro Vukmiroviq, e nuk është ndarë prej tij, edhe pse ia kanë mundësuar).

Përfundim

Historia e emërtimit të fëmijëve shqiptarë në Kosovë është historia e vet popullit shqiptar të kësaj treve shqiptare. Emërtimi i fëmijëve me emra shqip i filluar në prag të Luftës së Dytë Botërore dhe fill pas saj vjen e zgjerohet me kalimin e kohës. Dyzet vjetët e fundit mbizotërojnë emrat shqip.

Prireja e vënies së emrave shqip vazhdon edhe sot në Kosovë, për dallim nga Shqipëria, ku kanë marrë hov emrat e huaj, që shihet nga një sondazh i bërë në 3 klasa të para me 107 vogëlushë në Tiranë, ku dalin vetëm 8 emra shqiptarë (Demollari 2008).

Bibliografia:

DEMOLLARI, Elona (2008), "Në 3 klasa të para me 107 vogëlushë, 8 emra shqiptarë", *Shekulli*, 21 shtator 2008.

GASHI, A. Krasniqi, R. (2010), "Klark Berisha çdo 24 mars dëgjon historinë e sulmeve të NATO-s", *Koha ditore*, Nr. 4588, 24 mars 2010, f. 7.

HASANI, Hasan (2001), *5043 emra shqip për fëmijë*, Sh. B. Faik Konica, Prishtinë.

KOÇI, Ibrahim (2006), *Emrat vetjakë në funksion të identitetit individual dhe kombëtar*, Botim i autorit, Prishtinë.

KOSTALLARI, A. (1963), "*Njerëzit dhe emrat*", *Mësuesi*, 31 maj 1963.

KOSTALLARI, A., Domi, M., Daka, P. Mansaku, S. (1982) *Fjalor me emra njerëzish*, Sh. B. 8 Nëntori, Tiranë.

KOTI, Isidor (2010), "Në kërkim të emrave shqiptarë", *Tirana Observer*, 27 mars 2010.

SELIMI, Yllka (1989), "Dukuri të vënies së emrave vetjakë", *Etnografia Shqiptare*, nr. 16, Tiranë 1989, ff. 111-132.

LAMBERTZ, M. (1986) "Kanuni i Lekë Dukagjinit dhe emri Lekë në gjuhën shqipe", botuar në "Studime për nder të Aleksandër Xhuvanit", botim i ASHeRPSSH, Tiranë 1986, ff. 429-431).

SELIMI, Yllka (1989), "*Dukuri të vënies së emrave vetjakë*", *Etnografia Shqiptare*. Nr. 16, Tiranë 1989, ff. 111-132.

ZOTO, Vladimir (2005), *Fjalor emrash*, Sh. B. Desara, Tiranë.

Caka & Caka

Emrat femërorë

Emra femërorë: 716.436 nga gjithsej 1.512.054 (ose: 47,38% nga 100%)						
Periudha	1912-2007	1912-1938	1939-1948	1949-1968	1969-1988	1989-2007
Gjithsej	47,38%	3,78%	3,59%	13,01%	21,97%	5,03%
100 emrat e parë	42,35%	52,42%	52,13%	49,25%	50,09%	46,22%

Nr.	1912-1938		1939-1948		1949-1968		1969-1988		1989-2007	
	Emri	‰	Emri	‰	Emri	‰	Emri	‰	Emri	‰
1.	Fatime	25,6	Fatime	25,6	Fatime	20,0	Valbona	15,9	Edona	12,2
2.	Emine	14,9	Ajshe	14,0	Emine	12,6	Aferdita	15,5	Adelina	11,1
3.	Ajshe	13,9	Hava	13,8	Sevdije	12,5	Luljeta	13,7	Fitore	10,0
4.	Hava	13,5	Emine	13,1	Sanije	12,0	Ganimete	13,5	Kaltrina	10,0
5.	Xhemile	13,0	Xhemile	11,1	Ajshe	10,0	Merita	13,2	Liridona	9,9
6.	Hajrije	11,9	Sabrije	10,9	Hava	9,3	Shqipe	12,5	Blerta	9,5
7.	Hanife	11,6	Hajrije	10,5	Sabrije	9,2	Shpresa	12,0	Egzona	8,9
8.	Hamide	11,5	Feride	10,5	Drita	9,0	Vlora	11,0	Albulena	8,6
9.	Nurije	10,9	Nurije	9,7	Nexhmije	8,8	Vjollca	10,6	Dafina	8,2
10.	Feride	10,4	Fahrije	9,6	Shukrije	8,8	Teuta	9,6	Arta	8,1
11.	Vahide	9,2	Hamide	9,6	Remzije	8,6	Fatime	9,6	Blerina	8,0
12.	Sabrije	9,1	Fetije	9,5	Hajrije	8,4	Lumnije	9,5	Agnesa	7,8
13.	Fetije	8,7	Hanife	9,3	Sadije	8,3	Fatmire	9,4	Arlinda	7,8
14.	Zoja	8,3	Miradije	9,3	Fahrije	7,7	Drita	8,3	Marigona	7,7
15.	Naile	8,2	Sevdije	9,2	Mirvete	7,6	Florije	7,8	Gentiana	7,7
16.	Halime	7,9	Sadije	8,7	Nazmije	7,5	Violeta	7,7	Fjolla	7,4
17.	Miradije	7,7	Vahide	8,3	Feride	7,3	Mimoza	7,0	Besarta	7,2
18.	Sherife	7,6	Nazmije	7,8	Miradije	7,1	Emine	6,9	Donjeta	7,1
19.	Mihane	7,5	Shukrije	7,7	Bahrije	7,0	Bukurije	6,9	Valentina	7,0
20.	Zarife	6,8	Zoja	7,7	Hamide	7,0	Kimete	6,5	Albina	7,0
21.	Fahrije	6,7	Remzije	7,5	Xhemile	7,0	Shkurte	6,4	Anita	6,7
22.	Arife	6,6	Shefkije	7,2	Kimete	6,9	Lindita	6,2	Vlora	6,2
23.	Qamile	6,5	Nexhmije	7,1	Hanife	6,9	Valdete	6,2	Florentina	6,1
24.	Sadije	6,4	Naile	6,9	Fetije	6,8	Mirvete	6,2	Rina	5,9
25.	Hatixhe	6,4	Hatixhe	6,7	Fatmire	6,6	Valentina	6,2	Leonora	5,8
26.	Shehide	6,2	Zarife	6,6	Nurije	6,5	Sanije	6,1	Qendresa	5,8
27.	Nazife	6,1	Mihane	6,5	Bedrije	6,2	Lendita	6,1	Donika	5,8
28.	Zade	6,1	Sanije	6,3	Hatixhe	6,0	Lumturije	6,0	Gresa	5,8

Caka & Caka

29.	Shefkije	6,0	Halime	63	Zoja	5,7	Selvete	5,9	Saranda	5,6
30.	Habibe	6,0	Hasime	61	Florije	5,7	Leonora	5,7	Ardita	5,6
31.	Fazile	5,9	Sherife	61	Ganimete	5,2	Ardita	5,7	Mimoza	5,4
32.	Ramize	5,9	Naxhije	60	Vahide	4,9	Ibadete	5,4	Bleona	5,1
33.	Hasime	5,8	Shkurte	58	Hasime	4,8	Lirije	5,3	Djellza	4,9
34.	Shkurte	5,4	Habibe	58	Shkurte	4,7	Minire	4,9	Shkurte	4,9
35.	Naxhije	5,1	Nazife	55	Zarife	4,6	Arta	4,9	Albana	4,8
36.	Zylfije	5,0	Mihrije	55	Naxhije	4,6	Arjeta	4,7	Erza	4,8
37.	Azize	5,0	Qamile	53	Luljeta	4,6	Sevdije	4,7	Arjeta	4,7
38.	Nazmije	5,0	Shehide	53	Lumnije	4,5	Selviye	4,4	Elsa	4,4
39.	Sofije	4,8	Ramize	53	Shemsije	4,5	Mirlinda	4,2	Laura	4,4
40.	Mejreme	4,8	Arife	51	Shpresa	4,4	Besa	4,2	Jehona	4,3
41.	Zahide	4,6	Fazile	50	Mihane	4,4	Fitore	4,2	Mirlinda	4,3
42.	Tahire	4,5	Nafije	47	Mihrije	4,4	Shyhrete	4,1	Teuta	4,2
43.	Sabile	4,5	Sofije	44	Bukurije	4,4	Blerta	4,0	Rinesa	4,2
44.	Bahrije	4,4	Zylfije	43	Kumrije	4,4	Xhevahire	4,0	Merita	4,1
45.	Sanije	4,4	Mejreme	43	Safete	4,4	Antigona	3,9	Leonita	4,0
46.	Nexhmije	4,4	Sabile	41	Aferdita	4,3	Bahrije	3,9	Qëndresa	3,9
47.	Shukrije	4,2	Rahime	41	Minire	4,3	Ajshe	3,9	Mirjeta	3,9
48.	Hyra	4,1	Azize	40	Mejreme	4,2	Ardiana	3,9	Arbenita	3,9
49.	Raza	4,1	Bahrije	39	Xhevrije	4,2	Sadete	3,8	Valmira	3,9
50.	Azemine	4,1	Bahrije	39	Selvete	4,2	Arlinda	3,8	Kosovare	3,8
51.	Nafije	4,0	Zade	39	Halime	4,1	Remzije	3,8	Sara	3,7
52.	Mihrije	4,0	Zahide	38	Habibe	4,0	Shukrije	3,7	Shqipe	3,7
53.	Rahime	3,9	Azemine	38	Naile	4,0	Nexhmije	3,7	Diana	3,7
54.	Gjyle	3,9	Bedrije	38	Ramize	3,8	Hatixhe	3,6	Ardiana	3,5
55.	Ajete	3,8	Rukije	37	Sherife	3,8	Hava	3,6	Djellza	3,5
56.	Xhezide	3,7	Mehreme	36	Zejnije	3,7	Sadije	3,5	Elona	3,5
57.	Rabije	3,7	Hyra	36	Shefkije	3,7	Hanife	3,5	Vesa	3,5
58.	Hafize	3,6	Shaha	35	Igballe	3,7	Hajrije	3,5	Majlinda	3,5
59.	Shaha	3,5	Nazlije	35	Nafije	3,6	Albana	3,4	Alma	3,5
60.	Sala	3,5	Zejnije	34	Arife	3,6	Suzana	3,4	Yllka	3,4
61.	Rukije	3,5	Xhezide	34	Zyrafete	3,6	Zyrafete	3,4	Antigona	3,4
62.	Nazlije	3,5	Shemsije	34	Sofije	3,4	Hidajete	3,3	Dorentina	3,3
63.	Zelfije	3,4	Xhevrije	32	Qamile	3,4	Jehona	3,3	Shpresa	3,2
64.	Selime	3,4	Selime	32	Shehide	3,4	Nazmije	3,2	Dea	3,2

Caka & Caka

65.	Remzije	3,4	Adile	32	Mevlide	3,2	Hamide	3,2	Aurora	3,1
66.	Kada	3,3	Sala	31	Nazife	3,2	Adelina	3,2	Ermira	3,1
67.	Hajrie	3,1	Elheme	31	Lirije	3,2	Sabrije	3,1	Njomza	3,1
68.	Zejnije	3,1	Raza	30	Mevlude	3,1	Feride	3,1	Vanesa	3,0
69.	Mehreme	3,1	Rabije	30	Rukije	3,1	Bedrije	3,1	Valbona	3,0
70.	Raba	3,1	Gjyle	30	Servete	3,1	Fahrije	3,1	Altina	3,0
71.	Hysnije	3,1	Zelfije	29	Nazlije	3,0	Sebahate	3,1	Vlera	3,0
72.	Bahrije	3,0	Ajete	29	Xhevahire	2,9	Safete	2,9	Vjollca	2,9
73.	Marte	2,9	Tahire	29	Mehreme	2,9	Xhemile	2,9	Fatime	2,9
74.	Adile	2,9	Hysnije	29	Zade	2,9	Elfete	2,9	Lirije	2,8
75.	Zyhra	2,9	Mevlide	28	Rabije	2,9	Albulena	2,8	Miranda	2,8
76.	Zize	2,7	Hajrie	27	Hidajete	2,9	Fetije	2,8	Nora	2,8
77.	Nushe	2,7	Kumrije	27	Makfire	2,8	Makfire	2,7	Arbnora	2,8
78.	Fata	2,7	Hana	27	Vjollca	2,8	Igballe	2,7	Luljeta	2,7
79.	Hana	2,7	Vezire	27	Shyrete	2,8	Saranda	2,7	Tringa	2,7
80.	Elmaze	2,7	Taibe	26	Hysnije	2,8	Burbuqe	2,7	Albiona	2,7
81.	Dinore	2,6	Xhyla	26	Vezire	2,8	Mevlude	2,7	Besa	2,7
82.	Maitqe	2,6	Fata	25	Zejnepe	2,7	Magbule	2,6	Vjosa	2,6
83.	Shahe	2,6	Raba	25	Azemine	2,7	Kumrije	2,6	Era	2,6
84.	Xhyla	2,6	Hazbije	24	Fikrije	2,7	Shemsije	2,6	Medina	2,6
85.	Time	2,6	Mevlude	24	Selvije	2,7	Miradije	2,6	Aulona	2,5
86.	Xhevahire	2,5	Elmaze	23	Fazile	2,6	Resmije	2,6	Ariana	2,5
87.	Shemsije	2,5	Fikrije	22	Resmije	2,6	Florie	2,5	Zana	2,5
88.	Taibe	2,5	Elife	22	Elfete	2,6	Besarta	2,5	Leona	2,4
89.	Sevdije	2,4	Hafize	22	Zylfije	2,5	Hasime	2,5	Krenare	2,4
90.	Elfije	2,4	Xhevahire	22	Zahide	2,5	Fikrije	2,5	Fiona	2,4
91.	Hyre	2,4	Kada	22	Flurije	2,5	Melihate	2,4	Violeta	2,4
92.	Xhevrije	2,4	Miradie	21	Elheme	2,4	Nurije	2,4	Doruntina	2,4
93.	Hata	2,3	Gjyla	21	Sebahate	2,4	Pranvera	2,4	Elmedina	2,4
94.	Vezire	2,3	Nushe	21	Hana	2,4	Dafina	2,4	Arbresha	2,4
95.	Elife	2,3	Zejnepe	20	Bahrije	2,4	Sahadete	2,3	Anisa	2,3
96.	Gjyla	2,3	Halide	20	Shukrie	2,3	Majlinda	2,3	Edita	2,3
97.	Hanumshahe	2,2	Marte	20	Rahime	2,3	Edona	2,3	Elvira	2,3
98.	Elheme	2,2	Elfije	20	Sala	2,2	Mirjeta	2,3	Melisa	2,3
99.	Xufe	2,2	Zyla	19	Xhezide	2,2	Blerina	2,3	Verona	2,3
100.	Ryve	2,2	Dinore	19	Sevdie	2,2	Naime	2,3	Erblina	2,3

Caka & Caka

Emra mashkullorë: 795.618 nga gjithsej 1.512.054 (ose: 52,62% nga 100%)						
Periudha	1912-2007	1912-1938	1939-1948	1949-1968	1969-1988	1989-2007
Gjithsej	52,62%	3,54%	3,87%	14,62%	24,53%	6,06%
100 emrat e parë	24,74%	57,76%	55,77%	51,31%	53,06%	47,06%

Nr.	1912-1938		1939-1948		1949-1968		1969-1988		1989-2007	
	Emri	%	Emri	%	Emri	%	Emri	%	Emri	%
1.	Bajram	21,7	Bajram	16,8	Agim	15,6	Bekim	19,1	Egzon	13,4
2.	Ramadan	18,4	Ramadan	15,7	Ismet	14,5	Arben	15,8	Endrit	10,2
3.	Rexhep	15,8	Rexhep	15,0	Bajram	13,1	Besim	12,6	Liridon	9,8
4.	Shaban	15,8	Shaban	14,0	Ramadan	12,2	Blerim	12,4	Valon	9,7
5.	Ali	15,7	Ali	13,7	Fadil	12,2	Burim	12,3	Dardan	9,7
6.	Adem	12,9	Adem	12,5	Enver	11,7	Agron	11,8	Alban	9,5
7.	Hasan	12,6	Hasan	10,8	Skender	10,6	Avni	10,9	Kushtrim	9,0
8.	Ahmet	11,8	Ahmet	10,2	Gani	10,4	Naim	10,9	Granit	8,3
9.	Muharrem	10,4	Ismet	9,5	Rexhep	10,4	Afrim	10,8	Ardit	8,1
10.	Mehmet	10,3	Muharrem	9,3	Shaban	10,1	Fatmir	10,7	Arlind	7,9
11.	Halil	8,7	Gani	9,2	Naser	9,7	Driton	10,3	Rinor	7,7
12.	Ibrahim	8,5	Idriz	8,4	Afrim	9,5	Bashkim	10,1	Arbër	7,5
13.	Idriz	8,4	Mehmet	8,3	Ali	9,2	Arsim	9,9	Ardian	6,8
14.	Hamdi	8,4	Hysen	7,7	Fatmir	9,0	Besnik	9,8	Leutrim	6,8
15.	Hysen	8,1	Nazmi	7,6	Muhamet	8,5	Jeton	9,8	Armend	6,8
16.	Sadik	8,1	Ibrahim	7,5	Naim	8,2	Lulzim	9,3	Mergim	6,7
17.	Isuf	7,8	Halil	7,4	Adem	7,9	Bujar	9,1	Allin	6,7
18.	Osman	7,8	Osman	7,4	Nazmi	6,7	Ilir	8,9	Albin	6,6
19.	Kadri	7,4	Isuf	7,0	Ahmet	6,6	Agim	8,2	Besnik	6,4
20.	Imer	7,3	Kadri	6,9	Hasan	6,6	Valon	8,0	Fitim	6,4
21.	Qazim	7,0	Sadik	6,9	Sami	6,1	Faton	7,7	Besart	6,3
22.	Selim	6,9	Selim	6,8	Xhevat	5,9	Enver	7,6	Drilon	6,3
23.	Tahir	6,8	Imer	6,3	Mehmet	5,8	Muhamet	7,4	Ilir	6,2
24.	Islam	6,4	Xhafer	6,3	Muharrem	5,7	Mentor	7,3	Enis	6,2
25.	Beqir	6,4	Faik	6,2	Haki	5,6	Gazmend	7,2	Valmir	5,8
26.	Haxhi	6,4	Azem	6,1	Isuf	5,6	Sami	6,9	Flamur	5,7
27.	Sylë	6,3	Beqir	6,0	Idriz	5,5	Fadil	6,8	Labinot	5,6
28.	Sadri	6,1	Hamdi	5,9	Halil	5,4	Naser	6,8	Kastriot	5,4
29.	Brahim	6,0	Isa	5,8	Ramiz	5,3	Bajram	6,7	Arbnor	5,3

Caka & Caka

30.	Ramiz	6,0	Tahir	5,8	Besim	5,3	Florim	6,0	Pajtim	5,3
31.	Azem	5,9	Zeqir	5,7	Ibrahim	5,2	Skender	5,8	Agon	5,2
32.	Sylejman	5,9	Brahim	5,7	Imer	5,2	Gëzim	5,6	Albert	5,0
33.	Sali	5,8	Sadri	5,6	Bashkim	5,2	Alban	5,5	Florian	5,0
34.	Faik	5,6	Muhamet	5,6	Xhavit	5,0	Fitim	5,2	Qendrim	4,9
35.	Salih	5,6	Islam	5,5	Bedri	5,0	Visar	5,1	Visar	4,9
36.	Avdyl	5,6	Haki	5,4	Shefqet	4,9	Ramadan	4,9	Durim	4,8
37.	Arif	5,4	Ruzhdi	5,3	Fehmi	4,8	Arton	4,9	Taulant	4,8
38.	Zeqir	5,3	Ramiz	5,2	Sadik	4,8	Xhevdet	4,8	Edon	4,8
39.	Halit	5,3	Musa	5,2	Kadri	4,8	Kujtim	4,8	Jeton	4,6
40.	Asllan	5,3	Qazim	5,1	Isa	4,6	Artan	4,7	Albion	4,6
41.	Gani	5,3	Sali	5,1	Musa	4,5	Astrit	4,7	Valdrin	4,5
42.	Nezir	5,2	Sejdi	4,9	Ruzhdi	4,4	Ali	4,7	Florent	4,5
43.	Haki	5,2	Sylë	4,8	Hysen	4,4	Ardian	4,7	Driton	4,3
44.	Sherif	5,0	Salih	4,8	Xhafer	4,4	Adnan	4,6	Fisnik	4,3
45.	Murat	4,9	Avdi	4,8	Sabit	4,4	Armend	4,5	Veton	4,3
46.	Halim	4,8	Skender	4,7	Osman	4,3	Labinot	4,4	Denis	4,2
47.	Sejdi	4,8	Murat	4,7	Faik	4,2	Liridon	4,3	Astrit	4,2
48.	Zenel	4,6	Sahit	4,7	Hamdi	4,2	Nexhat	4,2	Gentrit	4,1
49.	Rifat	4,6	Haxhi	4,7	Avni	4,0	Kushtrim	4,2	Andi	4,1
50.	Musa	4,6	Asllan	4,6	Beqir	3,9	Ismet	4,1	Jetmir	3,9
51.	Avdi	4,5	Halit	4,6	Remzi	3,9	Bedri	3,8	Arian	3,9
52.	Jakup	4,5	Avdyl	4,5	Islam	3,9	Ekrem	3,8	Burim	3,8
53.	Fazli	4,5	Sabit	4,5	Selim	3,9	Shaban	3,7	Faton	3,7
54.	Ramë	4,4	Jakup	4,5	Sylejman	3,9	Albert	3,6	Fatlum	3,7
55.	Selman	4,4	Sylejman	4,5	Haxhi	3,8	Adem	3,6	Lirim	3,7
56.	Isa	4,3	Fehmi	4,5	Azem	3,7	Shkelzen	3,6	Arianit	3,7
57.	Xhemajl	4,3	Nezir	4,4	Ragip	3,7	Rexhep	3,6	Arben	3,7
58.	Shaip	4,3	Ilaz	4,4	Nexhat	3,7	Flamur	3,6	Gëzim	3,6
59.	Hazir	4,3	Fazli	4,4	Milaim	3,7	Fidan	3,5	Bujar	3,6
60.	Musli	4,2	Zenel	4,4	Jakup	3,7	Petrit	3,5	Jon	3,6
61.	Sahit	4,2	Shefqet	4,3	Sali	3,7	Berat	3,4	Leon	3,6
62.	Rrustem	4,2	Musli	4,3	Avdi	3,6	Ahmet	3,3	Blerim	3,6
63.	Jusuf	4,1	Arif	4,3	Sabri	3,6	Nazmi	3,3	Meriton	3,5
64.	Emin	4,1	Enver	4,2	Brahim	3,6	Luan	3,2	Lorik	3,5
65.	Hamit	4,0	Xhemajl	4,2	Sadri	3,4	Safet	3,2	Petrit	3,5

Caka & Caka

66.	Aziz	4,0	Shaip	4,2	Lulzim	3,4	Faruk	3,2	Ermal	3,4
67.	Mustafë	4,0	Ismail	4,2	Xhevdet	3,4	Fehmi	3,2	Artan	3,4
68.	Ilaz	4,0	Ramë	4,1	Agron	3,4	Valdet	3,1	Dion	3,4
69.	Ismail	4,0	Sherif	4,1	Shaip	3,4	Xhavit	3,0	Leotrim	3,3
70.	Shefki	4,0	Rrustem	4,1	Tahir	3,4	Gani	2,9	Berat	3,3
71.	Nazmi	3,7	Isak	4,1	Sylë	3,3	Xhevat	2,9	Fidan	3,2
72.	Qerim	3,6	Halim	4,0	Ekrem	3,3	Nexhmedin	2,9	Erion	3,2
73.	Mustaf	3,6	Xhevat	4,0	Qazim	3,2	Behar	2,9	Agron	3,2
74.	Sabit	3,5	Hazir	4,0	Murat	3,2	Mehmet	2,9	Mentor	3,2
75.	Ukë	3,5	Rifat	4,0	Milazim	3,2	Ramiz	2,8	Dren	3,2
76.	Miftar	3,5	Rasim	3,8	Zeqir	3,1	Hasan	2,8	Learit	3,2
77.	Rrahman	3,4	Shefki	3,7	Mehdi	3,1	Remzi	2,8	Gent	3,1
78.	Rasim	3,4	Daut	3,7	Asllan	3,1	Halil	2,8	Edison	3,1
79.	Vesel	3,4	Miftar	3,6	Qamil	3,1	Milaim	2,8	Art	3,0
80.	Feriz	3,4	Hamit	3,6	Nuhi	3,0	Ibrahim	2,8	Qëndrim	3,0
81.	Nazif	3,4	Emin	3,5	Rifat	3,0	Fatos	2,7	Behar	2,9
82.	Shaqir	3,4	Selman	3,5	Sejdi	3,0	Nehat	2,7	Leonard	2,9
83.	Daut	3,4	Mustafë	3,5	Rasim	3,0	Isuf	2,6	Genc	2,9
84.	Muhamet	3,4	Aziz	3,4	Shemsi	3,0	Fisnik	2,5	Adrian	2,9
85.	Ismajl	3,4	Nazif	3,3	Nexhmedin	3,0	Ylber	2,5	Kujtim	2,9
86.	Xhafer	3,3	Sami	3,3	Sahit	3,0	Përparim	2,5	Betim	2,8
87.	Zymer	3,3	Latif	3,3	Arif	3,0	Haki	2,4	Blendi	2,8
88.	Latif	3,3	Vesel	3,2	Halit	2,9	Shpejtim	2,4	Arton	2,8
89.	Riza	3,2	Ejup	3,2	Nezir	2,9	Besart	2,4	Ylli	2,8
90.	Veli	3,1	Rrahim	3,2	Avdyll	2,9	Muharrem	2,4	Besmir	2,8
91.	Raif	3,1	Rrahman	3,1	Zenel	2,9	Shpend	2,4	Kreshnik	2,7
92.	Sinan	3,1	Qerim	3,1	Ilmi	2,8	Kadri	2,3	Rilind	2,6
93.	Rrahim	3,0	Shaqir	3,1	Shefki	2,8	Azem	2,3	Korab	2,6
94.	Zef	3,0	Nuhi	3,0	Mustafë	2,8	Imer	2,2	Muhamet	2,6
95.	Ajet	3,0	Jahir	3,0	Ramë	2,8	Hysni	2,2	Amir	2,6
96.	Avdullah	3,0	Jusuf	3,0	Izet	2,8	Sabri	2,2	Blend	2,5
97.	Hajdar	3,0	Zymer	3,0	Fazli	2,8	Abedin	2,1	Festim	2,5
98.	Qamil	3,0	Ajet	3,0	Salih	2,7	Idriz	2,1	Bajram	2,5
99.	Xhemail	2,9	Ismajl	2,9	Sherif	2,7	Esat	2,1	Shpend	2,4
100.	Isak	2,9	Mustaf	2,9	Xhemajl	2,7	Sabit	2,1	Shkelqim	2,4